EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5720
E premte, 8 mars 2019
çmimi 0.40 €

Sevdije Vishi merr çmimin e mësimdhënëses së vitit

FAQE 6

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", NIK GJELOSHAJ

FAQE 4-5

FITORJA E SHQIPTARËVE NË TUZ AFIRMON IDENTITETIN KOMBËTAR

Lideri i koalicionit "Forumi shqiptar", Nik Gjeloshaj, ka thënë se fitorja e shqiptarëve është në të mirë të së ardhmes së Komunës së Tuzit. Ai ka treguar se ky koalicion ka fituar numrin më të madh të mandateve dhe së shpejti do të fillojë qeverisja. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", kryetari i Komunës së Tuzit, Nik Gjeloshaj, ka vlerësuar se qytetarët në Malësi kanë nevojë për vetëqeverisje të plotë e cila ka për qëllim realizimin e programit të hartuar së bashku me qytetarët. Ai ka thënë se fitorja e shqiptarëve në Tuz dëshmon vendosmërinë për afirmimin e identitetit kombëtar. Gjeloshaj ka bërë me dije se projekti kryesor i koalicionit qeverisës do të jetë ruajtja e identitetit. Ai i ka bërë thirrje lidershipit politik shqiptar të jetë i bashkuar për të vepruar në të mirën e kombit

KUVENDI MIRATON LIGJIN DHE PLATFORMËN PËR DIALOGUN

Kuvendi i Kosovës të enjten ka miratuar Projektligjin për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë dhe Platformën për dialogun mbi marrëveshjen përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Përfaqësuesit e koalicionit qeverisës kanë thënë se me miratimin e Ligjit dhe Platformën kufijtë e Kosovës janë të paprekshëm FAQE 3

Një i vdekur, dhjetëra të plagosur nga një aksident në Gjilan

FAQE 8

AKTUALE

USHTRIA ÇLIRIMTARE KISHTE STRATEGJI, ÇLIRIMIN E KOSOVËS F. 11

Nga Jakup KRASNIQI

'ZËRI I KOSOVËS', 'BOTA E RE' DHE FOTOGRAFIA E JASHARËVE F. 11

Lulëzim ETEMAJ

NË KUJTIM TË PAVDEKËSISË TË KOMANDANTIT LEGJENDAR ADEM JASHARI DHE FAMILJES JASHARI F. 9

Shkruan: Ibrahim GASHI

EKONOMI

ATK-JA SHTON AKTIVITETET PËR MBLEDHJEN E BORXHEVE TATIMORE F. 9

KULTURË

PRITET BINJAKËZIMI I KOMUNËS SË PRIZRENIT ME NJË KOMUNË TË MALTËS F. 9

SPORT

ADEMI: GRAMOZ VOKRRI I REFUZOI DISA POZITA NË FFK. DERËN E KA TË HAPUR F. 13

GRAMOZ VOKRRI: NUK JAM PJESË E FEDERATËS, AGIM ADEMI PO E SHKATËRRON FFK-në F. 13

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Ruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Meta: Roli i Britanisë, kyç për stabilitetin e Ballkanit

TIRANË, 7 MARS - Gjatë vizitës së tij në Britaninë e Madhe, presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, u prit të enjten nga Sir Alan Duncan, ministër për Evropën i Britanisë së Madhe. "Shqipëria beson në angazhimin e domosdoshëm të Britanisë së Madhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor edhe pas Brexit-it", theksoi presidenti Meta, "pasi vendi juaj ka një rol kyç në këto dekada për forcimin e stabilitetit në Ballkan".

Ministri Duncan dhe presidenti Meta ndanë qëndrime të njëjta mbi zhvillimet në rajon, progresin historik të Maqedonisë së Veriut si dhe për rëndësinë e dialogut Kosovë-Serbi, që të konkludojë në arritjen e një marrëveshje që do të forcojë stabilitetin dhe të ardhmen evropiane të gjithë rajonit.

Ministrin Duncan siguroi presidentin Meta se Britania e Madhe do të vijojë të jetë prezente në Shqipëri dhe në rajon me qëllim të konsolidimit të demokracisë dhe shtetit ligjor. Duke vlerësuar rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit në fushat e sigurisë, të luftës kundër krimit të organizuar dhe sundimit të ligjit, presidenti Meta theksoi rëndësinë e rritjes së bashkëpunimit ekonomik e tregtar midis dy vendeve në të ardhmen në nivele më të larta.

Ministri Duncan, në një postim në Tëitter ka publikuar një foto nga takimit me kreun e shtetit shqiptar. "Kënaqësi të shkëmbeja pikëpamjet mbi Ballkanin Perëndimor me presidentin e Shqipërisë, Ilir Meta. Marrëdhëniet Shqipëri-Britani janë në formë të shkëlqyeshme", ka shkruar ministri britanik.

Hale: Marrëveshja Kosovë - Serbi mund të arrihet gjatë këtij viti

Zëvendëssekretari amerikan i Shtetit, David Hale, tha se është koha të marrin fund provokimet nga të dyja palët: të pezullohen tarifat, që Beogradi dhe Prishtina t'u kthehen bisedimeve të drejtuara nga Bashkimi Evropian dhe që të dyja palët të jenë të përcaktuara për paqe

BEOGRAD, 7 MARS - Zëvendëssekretari amerikan i Shtetit, David Hale, i tha të përditshmes serbe "Danas", se nuk u takon Shteteve të Bashkuara që ta "diktojnë përfundimin e bisedimeve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit", për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet tyre.

Hale, i cili do të qëndrojë sot (e premte) dhe nesër (e shtunë) në Beograd dhe në Prishtinë, për t'i nxitur të dyja palët që të ulen në tryezën e bisedimeve, tha se "ka mundësi që gjatë këtij viti të arrihet një marrëveshje, nëse fillojnë bisedimet. "Është koha që të marrin fund provokimet nga të dyja palët: të pezullohen tarifat, që Beogradi dhe Prishtina t'u kthehen bisedimeve të drejtuara nga Bashkimi Evropian dhe që të dyja palët të jenë të përcaktuara për paqe", tha diplomati amerikan, ka përcjell "voa". Ai tha se Shtetet e Bashkuara nuk kanë një "recetë për zgjidhjen që duhet të jetë e zbatueshme dhe t'i kontribuojë qëndrueshmërisë afatgjatë të rajonit".

Hale pritet që këto qëndrime t'i diskutojë në Beograd dhe në Prishtinë. Në një njoftim të Departamentit Amerikan të Shtetit thuhet se "në Beograd ai do të bisedojë me zyrtarët serbë marrëdhëniet dypalëshe dhe do të nxisë kthimin në tryezën e bisedimeve për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën. Ai do të diskutojë edhe me drejtuesit e shoqërisë civile për çështje rajonale e globale, përfshirë ndikimin rus dhe kinez në Ballkanin Perëndimor".

Më pas, më 9 mars, në Prishtinë, ai do t'i takojë udhëheqësit e lartë të Kosovës "për ta nënvizuar mundësinë historike për të arritur një marrëveshje të plotë të normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë dhe për të kërkuar masa për të arritur një zgjidhje".

Hale, i cili më parë qëndron në Londër dhe në Ukrainë, është zyrtari më i lartë amerikan që kohët e fundit viziton Kosovën për t'i nxitur autoritetet që të hapin rrugën për vazhdimin e bisedimeve me Serbinë, të cilat janë pezulluar për shkak të kushtëzimit të tyre nga Beogradi me heqjen e tarifave ndaj mallrave serbe, që u vendosën nga Qeveria e Kosovës në nëntor të vitit të kaluar.

Javën që lamë pas dy zyrtarë të lartë të Këshillit Kombëtar të Sigurisë qëndruan për dy ditë në Kosovë për ta siguruar pezullimin e tarifave, ndërsa paralajmëruan shtimin e masave ndëshkuese nëse Kosova vazhdon t'i refuzojë kërkesat e tilla.

Kërkesat amerikane kanë nxitur përplasje të brendshme në Kosovë ndërmjet atyre që ngulin këmbë të dëgjohen këshillat amerikane dhe atyre që pohojnë se tarifat duhet tëpezullohen vetëm me garanci për përfundimin e bisedimeve me Serbinë me njohje të ndërsjellë.

Basha: Do ta shembim gjithë sistemin

TIRANË, 7 MARS - Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, në takimin me drejtorin për Politikat e Zgjerimit në BE, Christian Danielsson, i ka paraqitur atij një vizion të ri të opozitës. Nuk është më qëllim vetëm rrëzimi i kryeministrit Edi Rama, por edhe qeveria teknike dhe zgjedhjet e parakohshme.

Basha tha në një deklaratë për gazetarët pas takimit me zyrtarin e lartë, se duhet shembur i gjithë sistemi. Një vizion i ri, që siç tha Basha do të diskutohet jo vetëm brenda opozitës, por edhe me qytetarët dhe me grupet e interesit. "Opozita sot pati një mundësi për të shprehur vendosmërinë e saj për t'i qëndruar kësaj beteje me qytetarët për çlirimin e Shqipërisë nga qeverisja e krimit. Shprehëm vendosmëri që jo thjesht të largohet Rama, por të shembet ky sistem.

Duhet angazhim i plotë i gjithë faktorit shqiptar politik, por jo vetëm, i çdokujt që i dhimbset ky vend, për të ndërtuar së bashkua një sistem vlerash, që të garantojë drejtësi të pavarur duart e të cilit mos t'i lidhë më Rama, as ndonjë përsëritje e fenomenit Rama me emër dhe mbiemër tjetër.

Sot SHISH, media, ekonomia, prokuroria, janë në dorë të një njeriu dhe një grushti klientësh pranë tij. Duhet reformë kushtetuese, elektorale dhe vullnet politike", deklaroi Basha.

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kuvendi miraton Ligjin dhe Platformën për dialogun

Kuvendi i Kosovës të enjten ka miratuar Projektligjin për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë dhe Platformën për dialogun mbi marrëveshjen përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Përfaqësuesit e koalicionit qeverisës kanë thënë se me miratimin e Ligjit dhe Platformën kufijtë e Kosovës janë të paprekshëm

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 7 MARS - Kuvendi i Kosovës në seancën e jashtëzakonshme ka miratuar të enjten në leximin e dytë Projektligjin për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë. Ky ligj u miratua me 58 vota për dhe tri abstenime. Në tentimin e parë për votim në seancën e re, Platforma për dialogun mbi marrëveshjen përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk mori votat e mjaftueshme, por në votimin e dytë ajo mori 61 vota për. Tre deputetët e Partisë Socialdemokrate fillimisht nuk votuan për Platformën pasi që ata kërkuan që fillimisht të ketë 61 vota për nga koalicioni dhe më pas ata do ta japin votën.

Deputeti Dardan Molliqaj ka thënë fillimisht se pa 61 vota për të koalicionit Platforma nuk mund të jetë e pranueshme. "Nëse platforma nuk i ka 61 vota për, PSD-ja nuk e voton. Pra, partnerët e tjerë që janë pjesë e delegacionit duhet të sigurohen që i kemi të gjitha votat për platformën. Një platformë që nuk i ka 61 vota, për ne nuk është e pranueshme", ka thënë Molliqaj. Megjithatë, me votat e deputetëve nga Partia Socialdemokrate, Dardan Molliqaj, Aida Dërguti dhe Shqipe Pantin, platforma u miratua. Pas miratimit të ligjit dhe platformës për dialogun final, kryeparlamentari Kadri Veseli ka thënë se Kosova i ka thënë po dialogut i cili do t'i sigurojë ulësen në Organizatën e Kombeve të Bashkuara me sovranitet të plotë. Veseli i ka falënderuar deputetët që votuan për ligjin e dialogut dhe platformën për këtë proces. "Nga sot Kosova është gati të ballafaqohet në procesin e dialogut final i cili do të thotë për ne vetëm ulëse në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, do të thotë shtetësi e plotë, sovranitet i plotë, jo asociacion me kompetenca ekzekutive dhe jo cenim i sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës", ka thënë Veseli. Ai u ka bërë thirrje edhe LDK-së dhe LV-së që të bëhen pjesë e dialogut. "Thërras kolegët e opozitës që të bëhen pjesë e këtij procesi. Pjesëmarrja e tyre në procesin e ballafaqimit përfundimtar me Serbinë i ndihmon vetëm Kosovës, nuk i ndihmon specifikisht luftës politike një partie të caktuar as për të fituar e as për të humbur", ka deklaruar Veseli.

Kryeministri Ramush Haradinaj ka përshëndetur miratimin e Ligjit dhe Platformës për dialogun me Serbinë nga Kuvendi. "Votimi i sotëm në Kuvendin e Kosovës, i Projektligjit për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë dhe i Platformës për dialogun mbi Marrëveshjen përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, është votim për ruajtjen e Kosovës së 17 shkurtit 2008", ka thënë Haradinaj.

Ai ka shtuar se "me votën e sotme, nga shumica e të pranishmëve në Kuvend, i kemi hapur rrugë ekipit gjithëpërfshirës nga përfaqësues të pozitës, opozitës e shoqërisë civile si ekip që përfaqëson interesat kushtetuese dhe strategjike të Kosovës". "Po dëshmojmë edhe një herë përkushtimin tonë për paqen dhe stabilitetin në gjithë rajonin dhe për ndërtimin e fqinjësisë së mirë. Me Ligjin dhe Platformën ne i kemi dhënë ekipit negociator dokumentet bazë, në të cilat paraqitet pozicioni ynë, se kufijtë e Kosovës janë të paprekshëm dhe se nuk do të ketë nivel të tretë të pushtetit", ka thënë Haradinaj.

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, i cili është edhe bashkëkryesues i ekipit negociator, ka thënë se kjo çështje është e rëndësishme dhe duhet të diskutohet pasi, sipas tij, është në interes të vendit. "Procedurat janë të respektuara. Çdo vonesë dhe zvarritje ka implikime që nuk janë në interes të vendit", pati deklaruar Limaj para votimit të platformës për dialog.

Deputetët e partive në opozitë kërkuan mocion procedural për largimin nga rendi i ditës së Platformës për dialogun, pasi argumentuan se kjo platformë nuk mund të miratohet, sepse bazohet në Ligjin për dialogun i cili ka kaluar vetëm në lexim të parë në Kuvend. "LDK-ja propozon që kryeministri ta tërheqë kërkesën dhe ky debat të shtyhet për një ditë tjetër", ka thënë shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti. Por, mocioni procedural për këtë gjë nuk kaloi.

Në Platformën e prezantuar në Kuvend thuhet se Kosova pret që procesi i dialogut t? shtohet dhe përshpejtohet në vitin 2019 me qëllim të arritjes së një marrëveshje përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht të detyrueshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Hoxhaj: Është jetike të kemi konsensus për dialogun

Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka thënë se miratimi i platformës së delegacionit shtetëror për dialogun me Serbinë është një hap i rëndësishëm drejt vazhdimit të dialogut, i cili do të përfundojë me njohje të ndërsjellë dhe anëtarësim të Kosovës në OKB. "Është jetike që të kemi konsensus të brendshëm dhe koordinim të plotë në mënyrë që pozicioni i Kosovës në tavolinën e negociatave të jetë sa më i fortë. Viti 2019 paraqet një momentum të mirë për arritjen e një marrëveshjeje historike që do të na mundësojë ta përmbyllim shtetndërtimin, me njohje e ulëse në OKB dhe të fokusohemi në zhvillimin ekonomik të vendit tonë", ka thënë Hoxhaj.

Flet për "Epokën e re", Nik Gjeloshaj

Fitorja e shqiptarëve në Tuz

Lideri i koalicionit "Forumi shqiptar", Nik Gjeloshaj, ka thënë se fitorja e shqiptarëve është në të mirë të së ardhmes së Komunës së Tuzit. Ai ka treguar se ky koalicion ka fituar numrin më të madh të mandateve dhe së shpejti do të fillojë qeverisja. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", kryetari i Komunës së Tuzit, Nik Gjeloshaj, ka vlerësuar se qytetarët në Malësi kanë nevojë për vetëqeverisje të plotë e cila ka për qëllim realizimin e programit të hartuar së bashku me qytetarët. Ai ka thënë se fitorja e shqiptarëve në Tuz dëshmon vendosmërinë për afirmimin e identitetit kombëtar. Gjeloshaj ka bërë me dije se projekti kryesor i koalicionit qeverisës do të jetë ruajtja e identitetit. Ai i ka bërë thirrje lidershipit politik shqiptar të jetë i bashkuar për të vepruar në të mirën e kombit

EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 7 MARS - Kandidati i koalicionit "Forumi shqiptar", që ka fituar zgjedhjet në Komunën e Tuzit, Nik Gjeloshaj, ka thënë të enjten se falë bashkimit të partive politike shqiptare është arritur fitorja. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se kjo fitore do të jetë në të mirë të së ardhmes së Tuzit. "Falë veprimit të përbashkët të subjekteve nacionale shqiptare në Komunën e Tuzit, ne sot jemi në situatë të flasim dhe ta hartojmë mënyrën për të ndërtuar të ardhmen tonë. Projekti ynë parësor vazhdon të jetë veprimtaria me përkushtim në ruajtjen e identitetit tonë përmes institucioneve përkatësve të cilat duhet të themelohen në të gjitha fushat në nivelin lokal. Në këtë mënyrë do të kontribuojmë për vendosjen e një baze të mirëfilltë për të ndërtuar një të nesërme më të sigurt në të gjitha fushat e jetës, duke respektuar veçoritë dhe nevojat e çdo qytetari në territorin e Komunës së Tuzit", ka deklaruar Gjeloshaj.

Ai ka vlerësuar se qytetarët në Malësi kanë nevojë për vetëqeverisje të plotë e cila ka për qëllim realizimin e programit të hartuar së bashku me qytetarët. Sipas Gjeloshajt, fitorja e shqiptarëve në Komunën e Tuzit dëshmon vendosmërinë për afirmimin e identitetit kombëtar. "Popullata shqiptare e ka pritur dhe dëshiruar këtë moment, sidomos tashmë që kemi fituar komunën e plotë, pas pothuajse tri decenieve kërkesash të vazhdueshme, angazhimeve dhe veprimeve të panumërta, të vetëdijshëm se vetëm kështu mund ta ndërtojmë të ardhmen në komunën tonë, me forcat tona dhe njerëzit tanë", është shprehur ai, duke shtuar se lidershipi politik shqiptar duhet të jetë i bashkuar për të vepruar në të mirën e kombit.

"Epoka e re": *Z. Gjeloshaj, pas zgjedhjeve të së dielës Komuna e Tuzit do të drejtohet nga një shqiptar. Si e vlerësoni këtë proces zgjedhor dhe çfarë do të thotë për ju dhe shqiptarët në përgjithësi kjo fitore?*

Gjeloshaj: Ishte proces zgjedhor i rëndomtë, me sfida dhe angazhime të shumta, sidomos për subjektet tona politike kur gjendesh përballë forcave qeveritare me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për një fushatë jo të barabartë me subjektet e tjera pjesëmarrëse. Mirëpo, edhe krahas këtyre sfidave dhe përballjeve me probleme të ndryshme, vullneti, vendosmëria dhe, mbi të gjitha, përkushtimi i koalicionit 'Forumi shqiptar', në orientimin e drejtë dhe qëllimmirë për të ardhmen e malësisë, ka reflektuar me një vullnet të pashoq të elektoratit tonë jo vetëm këtu në trevat tona, por sidomos në radhët e mërgimtarëve tanë të cilët kanë dhënë kontribut të pashoq në rezultatin pozitiv nga zgjedhjet e para vendore në komunën e plotë të Tuzit.

afirmon identitetin kombëtar

Domethënia për banorët shqiptarë është dhe do të jetë afatgjatë, pasi ata e dëshmuan vendosmërinë për afirmimin e identitetit të vet kombëtar përmes veprimtarisë së strukturave nacionale shqiptare.

"Epoka e re": *Sipas rezultateve preliminare, koalicioni i shqiptarëve "Forumi shqiptar" ka marrë rreth 3 682 vota, duke fituar kështu 16 nga 32 mandate. Por, është raportuar se një nga socialdemokratët pritet të kalojë në radhët e koalicionit shqiptar. A mund të na tregoni se si do të rrjedhë procesi tash e tutje deri në marrjen e detyrës tuaj si kryetar?*

Gjeloshaj: Kuptohet se në raste të ngjashme gjithherë ka spekulime të ndryshme për opsione dhe kombinime të shumta për ta formuar pushtetin. Me rëndësi është se koalicioni ynë ka fituar bindshëm zgjedhjet, pra numrin më të madh të mandateve dhe natyrisht sa më parë do ta fillojmë procesin e formimit të pushtetit sepse qytetarët në Malësi kanë nevojë për një vetëqeverisje të plotë lokale, që kuadrot tanë sa më parë ta fillojnë punën për realizimin e pikësynimeve tona programore që i kemi hartuar bashkërisht me qytetarët. Andaj, besojmë se edhe ky proces do të rrjedhë normalisht, pasi ne si fitues i zgjedhjeve jemi në pozitën që ta përcaktojmë dinamikën dhe rrjedhën e këtij procesi.

"Epoka e re": *Kjo fitore e juaja është arritur falë bashkimit të tri partive politike shqiptare. Cili do të jetë projekti juaj për qeverisjen e kësaj komune?*

Gjeloshaj: Falë veprimit të përbashkët të subjekteve nacionale shqiptare në Komunën e Tuzit, ne sot jemi në situatë të flasim dhe ta hartojmë mënyrën për të ndërtuar të ardhmen tonë. Projekti ynë parësor vazhdon të jetë veprimtaria me përkushtim për ruajtjen e identitetit tonë përmes institucioneve përkatësve të cilat duhet të themelohen në të gjitha fushat në nivelin lokal. Në këtë mënyrë do të kontribuojmë për vendosjen e një baze të mirëfilltë për të ndërtuar një të nesërme më të sigurt në të gjitha fushat e jetës, duke respektuar veçoritë dhe nevojat e çdo qytetari në territorin e Komunës së Tuzit. Do të bëjmë çmos për tërheqjen e investimeve nga jashtë për ta avancuar zhvillimin ekonomik, për zvogëlimin e papunësisë si njërin ndër gjeneratorët kryesor për emigrimin e të rinjve tanë. Kjo duhet të ndalet duke krijuar parakushtet e duhura për një jetë normale në vendlindjen tonë.

"Epoka e re": *Sa do të jetë sfiduese për ju dhe për shqiptarët qeverisja e Tuzit?*

Gjeloshaj: Kuptohet se të qeverisësh në territorin që e do aq shumë dhe të menaxhosh me të mirat natyrore të tij, me resurset e pasura natyrore, ekonomike dhe kulturore në të mirën e bashkëvendësve, është ndjesi e veçantë dhe që ngjall optimizëm për të ardhmen e përgjithshme. Popullata shqiptare e ka pritur dhe dëshiruar këtë moment, sidomos tashmë që kemi fituar komunën e plotë, pas pothuajse tri decenie kërkesash të vazhdueshme, angazhime dhe veprime të panumërta, të vetëdijshëm se vetëm kështu mund të ndërtojmë të ardhmen, në komunën tonë, me forcat tona dhe njerëzit tanë.

"Epoka e re": *Z. Gjeloshaj, gjatë këtij procesi zgjedhor në Tuz liderët shqiptarë nga të gjitha vendet kanë bërë thirrje për ta votuar koalicionin 'Forumi shqiptar' që ju keni drejtuar. Tani, pas bashkimit të shqiptarëve dhe fitores, cili është mesazhi juaj për liderët shqiptarë?*

Gjeloshaj: U jemi mirënjohës të gjitha strukturave politike, kulturore, individëve dhe shoqatave të shumta nga hapësira mbarëshqiptare që na kanë inkurajuar ta formojmë koalicionin 'Forumi shqiptar', me emrin e listës zgjedhore 'Malësia na bashkon'. Kjo ishte shtysë e madhe për ne dhe elektoratin shqiptar në këto hapësira. Kënaqësia me rezultatin e arritur është e përbashkët dhe dëshiroj t'i falënderoj të gjithë ata vëllazërisht. Uroj që lidershipi politik shqiptar të gjendet në pikat e përbashkëta për të vepruar në të mirën e çdo qytetari shqiptar kudo që jeton. Opinioni evropian dhe më gjerë vlerëson të arriturat e kombit shqiptar dhe e kemi obligim të veprojmë bashkërisht për arritjen e standardeve më të larta për jetën e përditshme të banorëve dhe për afirmimin e përgjithshëm mbarëkombëtar.

Pritet binjakëzimi i Komunës së Prizrenit me një komunë të Maltës

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRIZREN, 7 MARS - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në zyrat e MKRS-së në Prizren ka pritur të enjten në takim ministrin e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Republikës së Maltës, Carmelo Abela, me të cilin ka diskutuar rreth bashkëpunimit në fushat e interesit të dyanshëm të dy shteteve mike, Republikës së Kosovës dhe asaj të Maltës, me theks në kulturë dhe trashëgimi kulturore. Ndër çështjet e bisedës në këtë takim ishte edhe fokusimi në qytetin e Prizrenit, duke bashkëpunuar në projekte konkrete mes dy shteteve. Madje, ministri Gashi i propozoi ministrit Abela që qyteti i Prizrenit të binjakëzohet me ndonjërin prej qyteteve të Maltës.

Ministri Gashi e ka informuar ministrin Abela për punën dhe politikat që zhvillon MKRS-ja. Ndër të tjera, ministri e njoftoi ministrin maltez se MKRS-ja ka themeluar edhe Inspektoratin e Trashëgimisë Kulturore si një mekanizëm që funksionon në kuadër të Trashëgimisë dhe në këtë drejtim Republika e Maltës do të mund të ndihmonte me përvojën e vet.

Ndërsa ministri Abela ka shprehur kënaqësinë që ndodhet në një qytet të mrekullueshëm, siç e quajti ai qytetin e Prizrenit. Ai vlerësoi se është e rëndësishme që përpos marrëdhënieve miqësore, mes dy vendeve të ketë edhe bashkëpunim konkret në fusha të caktuara.

Ministri Abela u shpreh se është i gatshëm të nënshkruajë marrëveshje me MKRS-në në fushat që i mbulon ajo, në mënyrë që të strukturohet bashkëpunimi në këto fusha ashtu që dy popujt të përfitojnë sidomos në trashëgimi kulturore ngaqë të dy popujt kanë një histori të gjatë.

Të dy ministrat u pajtuan që të konkretizohen planet për nënshkrimin e marrëveshjes bilaterale për bashkëpunim mes dy vendeve, ashtu që historia e dy popujve të ruhet dhe të kujtohet ndër gjeneratat që vijnë pas.

‘ZËRI I KOSOVËS’, ‘BOTA E RE’ DHE FOTOGRAFIA E JASHARËVE

Lulëzim ETEMAJ

Që prej 21 vjetësh, më 5, 6 dhe 7 mars, Kompleksi Memorial "Adem Jashari" në Prekaz të Drenicës vizitohet, në shenjë respekti ndaj luftës dhe rënies heroike të komandantit legjendar të UÇK-së, Adem Jashari, babait të tij, Shaban Jashari, vëllait, Hamëz Jashari, si dhe familjes së tij 20 anëtarëshe, 10 prej të cilëve ishin fëmijë, nga mijëra shqiptarë. Ky kompleks është vendi më i vizituar në Kosovë që nga pasçlirimi. Numri i përgjithshëm i vizitorëve, përfshirë edhe vizitorët e shumtë ndërkombëtarë, tashmë llogaritet të ketë shkuar në mbi 12 milionë. Një numër të tillë vizitorësh vështirë që do ta ketë pasur ndonjë vend tjetër në krejt Ballkanin. Ajo çfarë vizitorët ndeshin kur nisen në drejtim të kullës është panoja e madhe e mermerit, e vendosur në hyrje, me fotografinë e Shaban, Hamëz e Adem Jasharit. Në prapavijë të tyre qëndron emblema e UÇK-së.

Janë tepër të paktë ata persona që e dinë historikun e vërtetë të kësaj fotografie, e cila është bërë një nga fotografitë më të shpërndara





në media dhe njëkohësisht më të pëlqyera nga shqiptarë të shumtë, pjesëtarë dhe mbështetës të UÇK-së, që nga koha kur është publikuar për herë të parë në dy gazetat kryesore mbështetëse të luftës së UÇK-së, "Zëri i Kosovës" dhe gazeta studentore "Bota e Re". Këtë historik, vështirë që e dinë madje edhe vetë ciceronët e Kompleksit. Kjo mosnjohje ka të bëjë edhe me mugesën e çuditshme të këtyre dy gazetave në muzeun e këtij Kompleksi, "Qëndresa heroike e Jasharëve për liri", të hapur më 7 mars 2017, ku, krahas eksponateve të ndryshme të Komandantit Legjendar të UÇK-së, Adem Jashari, dhe familjës së tij, me motive nga më të ndryshmet, janë ekspozuar edhe gazetat tjera shqipe të kohës së luftës, përfshirë edhe ato që, si në fillim të daljes në skenë të UÇK-së, ashtu dhe në çastet e saj kritike, nuk janë shquar për qëndrimin mirëkuptues dhe dashamirës në raport me të dhe luftëtarët e saj.

Në këndin "Shtypi i Kohës", të muzeut, askund nuk gjendet asnjë ekzemplar i vetëm i dy gazetave të lidhura direkt, në vijë organizative, me UÇK- në: gazetës "Zëri i Kosovës" dhe

"Bota e Re".

"Zëri i Kosovës", ishte themeluar nga heroi Jusuf Gërvalla. Numri i parë është botuar prej tij në Nëntor të vitit 1981, ishte gazetë që botohej nga Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK), themeluesja e UÇK-së, dhe i kishte botuar dhe shpërndarë për mediat ndërkombëtare që nga fillimi komunikatat dhe deklaratat politike të saj, kur gazetat dhe mediet tjera të Kosovës nuk e kishin një guxim të tillë ose madje bënin raporte e reportazhe denigruese për të. Gjatë luftës në Kosovë drejtohej nga kryeredaktori, ish- i burgosuri politik, preshevari Adnan Asllani, njëherit njeriu që në fund të vitit 1997 e punoi emblemën e UÇK-së.

Gazeta "Bota e Re", ishte gazetë e Lëvizjes Studenore, Lëvizjes që më 1 Tetor 1997 e përmbysi statusquon vrastare në heshtje të Kosovës. Drejtohej nga Muhamet Mavraj, njëri prej liderëve kryesorë të Lëvizjes Studentore. "Bota e Re", ashtu si "Zëri i Kosovës", jo vetëm që ishte zë i fuqishëm i pushkëve të UÇK-së dhe luftës së saj të drejtë çlirimtare, por përmes kontakteve të drejtpërdrejta të kryeredaktorit Mavraj me Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së dhe LPK-në, luajti rol të jashtëzakonshëm edhe në mobilizimin e rinisë studentore të Kosovës për t'iu bashkangjitur radhëve të luftëtarëve të lirisë.

Janë pikërisht këto dy gazeta që e kanë botuar të parat fotografinë, që pas çlirimit të Kosovës u vendos në panon e madhe të mermerit në hyrje të kullës së Jasharëve. Kjo fotografi, e punuar nga Adnan Asllani, fillimisht me vetëm Adem e Hamëz Jasharin, ushtarët e UÇK-së përpara dhe emblemën e e UÇK-së në prapavi, është punuar gjatë dhjetorit të vitit 1998. Për botimin e saj, si pllakat për nevojat e Fondit të UÇK-së "Vendlindja Thërret", për t'iu shmangur çdo keqkuptimi apo keqinterpretimi, është marrë paraprakisht edhe pëlqimi i Rifat Jasharit. Pllakati e kishte këtë moto: "Atdheu në rrezik-Vendlindja thërret". Për qëllim e kishte përkrahjen e gjithanshme të luftës çlirimtare të UÇK-së.

Në vitin 1998, "Zëri i Kosovës" dhe "Bota e re" kanë bërë marrëveshje për të dalë me materiale të përbashkëta. Dhe, siç është praktikuar edhe me materialet e tjera gjatë këtij viti, edhe me rastin e Vitit të Ri 1999, si "Zëri i Kosovës" ashtu dhe "Bota e re", që botohej në Prishtinë, e botuan kalendarin e përbashkët me po këtë këtë fotografi.

Në marsin e vitit 1999, Adnan Asllani kësaj fotografie ia bashkangjet edhe Shaban Jasharin, ndërsa është botuar nga "Zëri i Kosovës" në prag njëvjetorit të rënies heroike të komandantit legjendar të UÇK-së, Adem Jashari, në luftime të ashpra, që u zhvilluan tri ditë radhazi me forcat policore dhe ushtarake të Serbisë, rënia e të cilëve shënon ditën e epopesë së lavdishme të UÇK-së, më 4 mars 1999. Mospërfshirja e këtyre dy gazetave të rëndësishme në këndin "Shtypi i kohës", të Kompleksit Memorial "Adem Jashari", është një lëshim që e dëmton rënd historikun e shtypit shqip të Kosovës dhe rolin e tij në luftën çlirimtare. Si i tillë, ai duhet të korrigjohet nga menaxhmenti i muzeut, Agjencia për Menaxhimin e Kompleksëve Memoriale. "Zëri i Kosovës" dhe "Bota e re" e meritojnë një trajtim dinjitoz.

Sevdije Vishi merr çmimin e mësimdhënëses së vitit

EPOKA E RE Qendresa RAMA

FERIZAJ, 7 MARS - Me rastin e 7 Marsit, Ditës së Mësuesit, ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka ndarë çmimin tradicional "Shaban Jashari", për mësimdhënësin e dalluar të vitit, i cili çmim këtë vit i është ndarë mësueses Sevdije Vishi nga Komuna e Ferizajt. Me këtë rast, ministri Bytyqi ka uruar të gjithë mësimdhënësit e Kosovës për këtë festë dhe i ka falënderuar ata për përkushtimin e tyre për edukimin e brezave të rinj. Pasi që ka theksuar rëndësinë e kësaj dite, ministri Bytyqi kujtoi përpjekjet e vazhdueshme të shqiptarëve për t'u arsimuar, shkollën e parë shqipe dhe ideatorin e organizuesin e saj, Pandeli Sotiri dhe shumë patriotë të asaj kohe.

Ndër të tjera, ministri Bytyqi theksoi se kjo ditë feste, përveç që na e kujton të kaluarën, na bën të mendojmë edhe për përgjegjësitë që duhet t'i marrim për ta ngritur cilësinë në sistemin e arsimit. "Kjo nuk mund të bëhet vetëm duke ndërtuar politika, por barra kryesore ju bie

juve, mësimdhënës të nderuar. Ne jemi të vendosur që të gjithë mësimdhënësit e dalluar t'i shpërblejmë dhe t'i duartrokasim për punën e tyre, njëkohësisht t'i stimulojmë edhe të tjerët që të bëjnë po të njëjtat përpjekje, sepse kjo është një kauzë e jona e përbashkët", ka thënë Bytyqi.

Ai ka kërkuar nga mësimdhënësit që së bashku të punohet për ta kthyer në vendin e duhur meritokracinë e profesionit të mësimdhënësit në shoqërinë tonë, sepse ka pohuar se kjo meritokraci do të sigurojë një edukim dhe arsimim cilësor për të rinjtë tanë, që është edhe garantues i zhvillimit në vendin tonë. Në këtë ceremoni janë ndarë edhe mirënjohje për mësimdhënësit e dalluar nga secila komunë.

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur një tryezë diskutimi lidhur me të ardhmen e dialogut Kosovë - Serbi

Lebet: Rishkrimi i kufijve asnjëherë nuk ka funksionuar

Ambasadori i Zvicrës në Kosovë, Jean Hubert Lebet, ka bërë me dije të enjten se rishikimi i kufijve asnjëherë nuk ka funksionuar. Në tryezën e KDI-së, ku u diskutua lidhur me të ardhmen e dialogut Kosovë - Serbi, ambasadori zviceran ka deklaruar se këmbimi i territoreve nuk sjell paqe të qëndrueshme. Sipas tij, nëse palët nuk dëshirojnë të arrijnë tek një marrëveshje atëherë ajo nuk do të ndodhë

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 7 MARS - Ambasadori i Zvicrës në Kosovë, Jean Hubert Lebet, është shprehur kundër përfshirjes së temës së ndryshimit të kufijve për të arritur një marrëveshje me Serbinë. Në tryezën e KDI-së, ku u diskutua lidhur me të ardhmen e dialogut Kosovë - Serbi, diplomati zviceran ka theksuar se mësimi kryesor në marrëdhëniet ndërkombëtare është se ridizajnimi i kufijve nuk ka funksionuar asnjëherë. "Pikë së pari, mund të them se rishikimi i kufijve asnjëherë nuk ka funksionuar. Kjo nuk ka dhënë paqe të qëndrueshme. Nëse nuk kujdesen vazhdimisht për paqen, të njëjtat gjëra do të jenë të gjalla edhe pas lëvizjes së kufijve, madje vetëm sa do të bëhen edhe më të komplikuara", ka thënë Lebert, duke përmendur edhe gjërat e tjera që nuk duhen bërë në procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Sipas tij, nëse palët nuk dëshirojnë të arrijnë te një marrëveshje atëherë ajo nuk do të ndodhë. "Mësimi tjetër është se mos bëni asnjëherë marrëveshje me zor, madje edhe më pak për këto imponimet për të shtyrë me forcë përpara. Më lejoni të kujtoj çfarë tha presidenti Trump: 'mos u nxitoni, mos u nxitoni'. Kjo është në 'Guardian' më 27 shkurt dhe mund ta gjeni aty. Mësimi i tretë është se nuk ka asnjë model ku duhet të merret model për ndonjë vend. Nënshkrimi i një marrëveshjeje nuk është mësimi kryesor. Nëse palët nuk dëshirojnë të arrijnë një marrëveshje, atëherë kjo nuk do të ndodhë", ka thënë ai.

Ismet Kryeziu, drejtor ekzekutiv i KDI-së, i cili në hyrje të diskutimit ka bërë një përmbledhje të përgjithshme të zhvillimeve të fundit rreth procesit të dialogut Kosovë - Serbi, ka ngritur disa prej çështjeve aktuale që lidhen me vizionin rreth dialogut, koordinimin e delegacionit shtetëror dhe institucioneve të tjera kushtetuese lidhur me fazën përmbyllëse të dialogut, si dhe cili do të jetë roli i Kuvendit të Kosovës në këtë proces. Duke folur rreth përmbajtjes së projektligjit për delegacionin shtetëror, ai ka treguar se KDI-ja ka përgatitur një analizë mbi këtë projektligj, të cilën KDI-ja ua ka përcjellë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Bashkëkryesuesit e delegacionit shtetëror, Fatmir Limaj dhe Shpend Ahmeti, nuk janë të pranishëm në këtë tryezë, ndërsa Kryeziu ka thënë se shpreson që kjo të mos jetë ikje prej përgjegjësisë. "Siç po e shohim, bashkëkryesuesit e delegacionit nuk janë në diskutim, sepse për sot është caktuar edhe një seancë e jashtëzakonshme. Shpresojmë që të vijnë dhe shpresoj që kjo nuk do të jetë një ikje nga përgjegjësia e tyre në dialog", ka thënë Kryeziu.

Anëtarët e pranishëm të shoqërisë civile në këtë tryezë ngritën çështje të ndryshme të cilat lidhen me procesin e deritanishëm të dialogut Kosovë - Serbi, ku theksuan se niveli i zbatimit të marrëveshjeve të arritura deri më tani ka qenë i ulët. Po ashtu, është diskutuar lidhur me kompetencat dhe mandatin e delegacionit shtetëror, mungesën e legjitimitetit, mungesën e unitetit të spektrit politik, ku u vlerësua se kjo po reflektohet edhe në mungesën e bashkërendimit institucional lidhur me fazën përmbyllëse të dialogut.

Rëndësi e veçantë në këtë debat iu kushtua edhe akteve të nxjerra nga institucionet e ndryshme lidhur me dialogun, siç janë: rezoluta, projektligji dhe platforma për dialogun, për të cilat u tha se nuk do të kenë efekt praktik pa një vullnet politik për konsensus të gjerë të spektrit politik. Pjesë tjetër e këtij diskutimi ishte edhe taksa prej 100 përqindësh ndaj produkteve të importuara nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina.

Thaçi me kryediplomatin e Maltës diskuton për përkrahjen në integrimet evropiane

PRISHTINË, 7 MARS (ER) - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, të enjten ka pritur ministrin e Punëve të Jashtme të Maltës, Carmelo Abela. Thaçi e ka falënderuar kryediplomatin e Maltës për mbështetjen e vazhdueshme për Kosovën. "Malta është ndër vendet e para që ka njohur Kosovën. Jemi mirënjohës për përkrahjen e vazhdueshme dhe e mirëpres thellimin e bashkëpunimit ndërshtetëror", u shpreh presidenti Thaçi. Edhe ministri i Jashtëm i Maltës ka theksuar se Malta do të vazhdojë të përkrahë Kosovën në rrugën e integrimit evropian. "Anëtarësimi në Bashkimin Evropian, në NATO dhe OKB, janë aspirata të Kosovës", është shprehur presidenti Thaçi.

Në kujtim të pavdekësisë të komandantit legjendar Adem Jashari dhe familjes Jashari

Shkruan: Ibrahim GASHI

Jemi sot këtu pas 21 vjetësh nga qëndresa heroike, e veçantë dhe e pashembullt e Adem Jasharit dhe nga akti sublim i një familjeje të tërë. Ngjarja që ndodhi, që tashmë është e njohur nga të gjithë, ishte diçka përtej asaj që mund të imagjinohej, përtej reales, ishte një legjendë, prandaj pati efektin e menjëhershëm, ndezi mijëra e mijëra zemra, duke i dhënë popullit të Kosovës besimin se liria mund të arrihej nëse për të luftohej me vetëmohim, ndërsa botës i dha mesazhin se shqiptarët nuk mund të qëndronin edhe më tej të shtypur e të maltretuar, në mbyllje të shekullit XX, kur Evropa po mburrej për standardët e larta të respektimit të drejtave të njeriut, të lirisë e të demokracisë.

Adem Jashari, gjithë familjet Jashari, kontribuuan përtej çdo pritjeje, për të forcuar besimin dhe bashkimin mbarëkombëtar, duke vitalizuar dhe rritur Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Flijimi i Jasharajve i dha Kosovës me mijëra çlirimtarë të cilët do të jen të aftë që të bindnin botën për drejtësinë e luftës së tyre dhe të ndërgjegjësojnë faktorin ushtarak ndërkombëtar për të mbështetur këtë luftë të drejtë deri në fitoren e plotë, çlirimin e Kosovës.

Nëse i referohemi një trajektore historike, që nga viti 1991 deri më 1998, Prekazi dhe Drenica survijoheshin parreshtur nga organet policore dhe nga forcat paramilitare serbe. Synimi ishte vrasja e komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari dhe familjes së tij, për të shuar dhe shtypur rezistencën që familja Jashari me në krye Ademin e Hamzën po ia bënin regjimit të Sllobodan Millosheviqit.

Ngjarjet dramatike, të hapëta, kundër familjes Jashari kishin filluar më datën 30 dhjetor të vitit 1991, me ç'rast familja e Jasharëve rrethohet nga forcat policore dhe ushtarake serbe. Tre vëllezërit Jashari: Ademi, Rifati dhe Hamza nuk pranuan tu dorëzoheshin kriminelëve serbë, por iu kundërpërgjigjën me zjarr, duke çarë rrethimin, ku lanë dhjetëra ushtarë dhe policë serb të plagosur.

Rrethimi i dytë i familjes Jashari u bë më 22 janar të vitit 1998. Forcat serbe sulmuan familjen Jashari. Edhe këtij sulmi Jasharët, burra, gra dhe fëmijë, i rezistuan. Megjithatë, në këtë betejë që zgjati afër 30 minuta, të plagosura mbeten Iliriana, vajza e Rifat Jasharit dhe Selvetja, vajza e Hamzë Jasharit, që ishin në mbështetje të luftëtarëve të Jasharëve.

Pas kësaj beteje dhe vrasjes së një punëtori shqiptar afër fabrikës së municionit dhe një zyrtari serb, do të shkruaj studiuesi Stephan Schwartz, ora e luftës në Drenicë po binte. Forcat serbe kryen ekzekutime dhe masakrime te grupeve të civilëve shqiptarë, në Likoshan afër Drenasit dhe në Qirez të Skenderajt më 28 shkurt. Këto katunde vazhdon Schwartz u sulmuan mbi 24 pa ndërpre me operacione të kombinuara, por edhe një numër policësh, paramilitarësh dhe ushtarësh serbë pësoi në to. Në shenjë hakmarrje familjes Ahmeti ju vranë të gjithë meshkujt deri në një. Edhe studiuesi dhe gazetari i njohur britanik Tim Juda në librin e tij "Kosova luftë dhe hakmarrje" shkruan se pjesëtaret e UÇK-së kishin shpëtuar të gjithë por policet serb pasi lanë shumë të vrarë e kuptuan se tani me duhej të ndryshonin taktikë. Duhej të ndërmerrnin një sulm të gjerë kundër familjes së Adem Jasharit.

Sulmi filloi herët në mëngjesin e 5 marsit. Për tri ditë rresht, më 5, 6 dhe 7 mars, familja heroike me në krye komandantin legjendar - Adem Jasharin u bëri ballë sulmeve të pareshtura të makinerisë serbe. Familja Jashari këtë herë do të qëndronte për jetë a vdekje. Shpëtuan nga kjo betejë vetëm Besarta dhe Bashkimi. Ndërsa nuk ndodheshin në shtëpi, bacë Rifati, Murati, Bekimi dhe Lulzimi që gjendeshin në emigracion, si dhe Iliriana, Shqipja, Marigona dhe Fazliu, të cilët një ditë më parë kishin shkuar në Okrashticë. Adem Jashari me familjen para se të vriteshin i kishin dhënë besën njëri - tjetrit se, të gjithë do të luftonin deri në vdekje për çlirimin e vendit. Para se të vritej komandanti Adem Jashari kishte deklaruar: "Nuk do të dorëzohem për së gjalli, vrastarët nuk do të kalojnë veçse mbi trupin tim të vdekur".

Duke e parë dhe dëgjuar këtë histori trimërie dhe përkushtimi atdhetar vetëmohues deri në vetëflijim të një komandanti dhe të një familjeje të tërë, narracioni ka fituar një dimension tjetër. Sot Adem Jashari është emri më i pranishëm në opinion shqiptar, është edhe personaliteti më i pranueshëm i periudhës së zhvillimeve më të reja historike që sollën ndryshime rrënjësore në jetën tonë. Emri që u bë sinonim i luftës çlirimtare të shqiptarëve në Kosovë e në vise të tjera etnike, ku u shënuan përpjekje të këtilla. Me një fjalë, Adem Jashari është përfaqësuesi më i denjë i luftëtarëve kundër robërisë, përfaqësuesi emblematik i mijëra dëshmorëve të lirisë, i sakrificës më madhore të një udhëheqësi të luftës çlirimtare, madje kundruar edhe në përmasa përtej kombëtare. Për këtë arsye gjithçka që ka të bëjë me Adem Jasharin, biografinë, veprimtarinë dhe jehonën e aktit të tij madhor, është bërë objekt i shqyrtimeve në shkrime të karakterit të ndryshëm historik, publicistik, eseistik, letrar dhe një krijimtari e tërë po i kushtohet veprës së tij.

Studiues eminent heroizmin e Jasharajve e trajtojnë si fenomen i cili ndihmon për studimin e nacionalizmit nga "një perspektivë e një ngjarjeje",[eventfulness of nationalism] siç e ka definuar sociologu shumë i njohur amerikan Rogers Brubaker. Masakra e Prekazit na ofroi një mundësi unik për të kuptuar marrëdhënien midis kujtesës, historisë dhe kombit, ashtu siç përjetohet dhe negociohet. Studiuesja Ana de Lellio do të shkruaj "Jasharët u vranë dhe, edhe pse ka pasur fëmijë mes tyre nuk konsiderohen viktima, por heronj që nuk pranojnë të dorëzohen. Ata janë konsideruar 'dëshmorë të kombit'… ata dëshmojnë me martirizimin e vet se kombi ekziston. Komandanti Legjendari është figurë mitike sepse ai lidh brezat e kaluar dhe të ardhshëm me kombin."

Adem Jashari identifikohet lehtë nga figurat e tjera heroike vendore; ai është mishërim i imazhit të "patriotit të vërtetë shqiptar". Në një mënyrë fare moderne, ai e kishte ndërtuar veten si figurë legjendare. Thuhet se stili i tij ishte ai i kryengritësit kundër osmanëve, Çerçiz Topullit. Nga bashkëluftëtarët përshkruhet fjalë pak, por edhe kur fliste përdorte fjali teatrale si në fjalimin mbajtur para shokëve të tij pas sulmit policor në Likoshan: "ju sot jeni plagosur që ne të jemi nesër të lirë".

Thënia e filozofit të madh gjerman Hegel se: Liria e një populli merr kuptimin e vërtetë, vetëm kur njeriu tregon se është i gatshëm të vdes për të" u provua më rastin e luftës çlirimtare të Kosovës. Vërtetësinë e kësaj thënie profetike e vulosën më aktin e tyre të vetëflijimit Adem Jashari, familja Jashari dhe mijëra dëshmorë dhe martirë anë e kënd Kosovës.

Një i vdekur, dhjetëra të plagosur nga një aksident në Gjilan

Gjilan, 7 mars (ER) - Të paktën një person ka vdekur dhe 20 të tjerë janë lënduar nga një aksident që ka ndodhur të enjten në qendër të qytetit të Gjilanit. Aksidenti ka ndodhur pasi një kamion, për shkak të problemeve teknike, ka aksidentuar tetë vetura dhe kalimtarë të rastit. Për këtë ngjarje ka reaguar, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri. "Sipas informatave të para, kamionit me targa 01 nuk i kanë funksionuar frenat dhe, pos dëmeve në njerëz, ka shkaktuar edhe dëme të mëdha materiale, ku janë përfshirë dhjetëra vetura dhe dëmtim i pronës publike. Lutem që familjet e personave të prekur ta përballojnë këtë dhembje që është tragjike për të gjithë ne", ka shkruar Haziri.

Për këtë aksident ka reaguar edhe presidenti Hashim Thaçi dhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli. Ata i kanë shprehur ngushëllime familjes së personit që humbi jetën në këtë aksident, duke u uruar shërim të lënduarve.

Edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka reaguar për këtë aksident, duke i shprehur ngushëllime familjes së personit që humbi jetën në këtë aksident. "Thellësisht i tronditur nga tragjedia e sotme në qendër të Gjilanit, ku humbi jetën një person dhe 20 të tjerë u lënduan. Familjes së personit që ka humbur jetën i shprehim ngushëllimet më të sinqerta, kurse të lënduarve shërim sa më të shpejtë. Nga informatat që kemi marrë, kuptuam se aksidenti ndodhi pasi një kamion, për shkak të problemeve teknike, ka aksidentuar tetë vetura dhe kalimtarë të rastit", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Kryeministri Haradinaj u ka bërë thirrje organeve përgjegjëse që t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për ta hetuar rastin dhe për të parandaluar që raste të tilla të ndodhin në të ardhmen.

SHALA TAKOHET ME MINISTRIN E JASHTËM TË MALTËS, KËRKON RRITJEN E BASHKËPUNIMIT EKONOMIK

EPOKA E RE A. MAVRAJ

Prishtinë, 7 mars - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka pritur të enjten ministrin e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë të Maltës, Carmelo Abela, me të cilin ka diskutuar për thellimin e bashkëpunimit dhe rritjen e shkëmbimeve tregtare. Ministri Shala ka theksuar se marrëdhëniet e mira politike dhe diplomatike në mes dy shteteve të reflektohen edhe në aspektin ekonomik, duke u pajtuar për rritje të shkëmbimeve tregtare në mes të Kosovës dhe Maltës. "Kosova dhe Malta kanë marrëdhënie të shkëlqyera diplomatike. Unë dhe ministri Abela u pajtuam dhe u zotuam se këto marrëdhënie të mira në mes të dy shteteve në aspektin politik t'i shndërrojmë edhe në aspektin tregtar dhe besoj se ky takim të llogaritet si një fillim i mbarë që marrëdhëniet tona tregtare të kenë një nivel tjetër nga ai që është sot", ka thënë ministri Shala.

Ministri i MTI-së, Endrit Shala, e informoi ministrin e Maltës, Carmelo Abela, për mundësinë dhe potencialin që ofron Kosova për investitorët e huaj dhe për lehtësirat që i ofron Ligji për Investime Strategjike. "Republika e Kosovës ofron mundësi të jashtëzakonshme për investitorët e huaj për shkak të shumë arsyeve, duke u nisur nga më e rëndësishmja, që Kosova ka një rini shumë inovative dhe krijuese, po ashtu tatimet e favorshme dhe Ligji për Investime Strategjike krijon lehtësira për çdo investitor që e ka në plan investimin në vendin tonë", ka deklaruar ministri Shala. Ai e ka falënderuar ministrin Abela për kontributin që ka dhënë për ndërtimin e shtetit të Kosovës nëpër etapa të ndryshme. Ndërsa ministri i Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Maltës, Carmelo Abela, ka thënë se shteti i tij do ta vazhdojë mbështetjen për Republikën e Kosovës, duke e ndihmuar në aspektin e fuqizimit ekonomik dhe rritjes së shkëmbimeve tregtare.

SPITALI I MITROVICËS DHE 'ARIANI COMPANY' I SHTOJNË 'VALËS' 650 KONSUMATORË

Prishtinë, 7 mars (ER) - Spitali regjional në Mitrovicë dhe kompania më e madhe ndërtimore në rajonin e Mitrovicës, "Ariani Company", janë të fundit që ua kanë besuar shërbimet dhe rrjetin e shpejtë të internetit operatorit publik "Vala".

Janë 450 punonjës të këtij institucioni shëndetësor, të cilët do të komunikojnë mes vete dhe me të gjitha spitalet e regjioneve të tjera që janë në varësi të ShSKUK-së. "Të gjithë mantelbardhët dhe stafi teknik i spitalit tonë do të jemi tash e tutje me 'Valën' dhe kjo është një përparësi e madhe për punën dhe misionin tonë", ka bërë me dije drejtori i spitalit "Sami Haxhi Beqiri" në Mitrovicë, dr. Enis Istrefi.

Në të njëjtën ditë, Telekomit të Kosovës i është bashkëngjitur edhe ndërmarrja ndërtimore "Ariani Company" me seli në Vushtrri, me rreth 200 punonjës të saj. "Është shumë lehtësuese për specifikën e punës së ndërmarrjes sonë ky bashkëpunim me 'Valën', për arsye se rrjeti i saj i internetit dhe pajisjeve të tjera teknologjike na ndihmon së tepërmi që të jemi edhe më të suksesshëm dhe efektiv", ka thënë Naser Imeri, pronar i "Ariani Company".

Sjellja e institucioneve dhe kompanive të reja në "Vala" gjatë fillimit të këtij muaji dhe realizmi i dhjetëra kontratave të tjera komerciale dhe individuale kohët e fundit janë sinjale të duhura për orientimin e ri të Telekomit të Kosovës. "Me nënshkrimin e këtyre dy kontratave, sot kompanisë sonë iu shtuan mbi 650 konsumatorë të rinj dhe kjo më bën jashtëzakonisht krenar se Telekomit të Kosovës gjithnjë e më fuqishëm janë duke i besuar bizneset, institucionet dhe qytetarët", ka theksuar kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi.

ATK-ja shton aktivitetet për mbledhjen e borxheve tatimore

Prishtinë, 7 mars (ER) - Menaxhmenti i lartë i Administratës Tatimore të Kosovës ka marrë vendim për shtimin e aktiviteteve tek të gjithë tatimpaguesit të cilët kanë obligime të pashlyera në ATK. Ky hap është ndërmarrë bazuar në procedurat ligjore të mbledhjes së detyrueshme, në momentin kur tatimpaguesit i tejkalojnë afatet ligjore për përmbushjen e obligimeve tatimore.

Gjatë periudhës janar-shkurt 2019, bazuar në Ligjin Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe procedurat, janë zhvilluar shumë aktivitete operative me qëllim të mbledhjes së borxheve, duke njoftuar tatimpaguesit për obligimet që kanë. Dispozitat ligjore parashohin që për secilin tatimpagues i cili nuk u bindet kërkesave ligjore, të ndërmerren masa si vendosja e barrës tatimore, bllokimi i llogarive bankare, bllokimi i import-eksporteve, ndalesa në Thesar, konfiskimi i pasurisë, ngritja e kallëzimeve penale dhe veprime të tjera ligjore.

Si rezultat i aktiviteteve të mbledhjes së detyrueshme ATK-ja, për dy muajt e parë të vitit 2019 ka inkasuar 10.3 milionë euro tatime dhe 898 mijë euro kontribute pensionale. Prioritet i ATK-së mbetet mbledhja e borxheve të reja dhe borxheve të tjera të papaguara, me theks të veçantë mbledhja e gjobave mandatare dhe konfiskimi i pasurisë, për tatimpaguesit që kanë borxhe të pashlyera. ATK-ja inkurajon të gjithë

tatimpaguesit që t'i kryejnë me kohë obligimet e tyre, të cilat janë të përcaktuara me dispozitat e legjislacionit tatimor, në mënyrë që të mos bëhen objekt i masave të mbledhjes së detyrueshme.

Gjakova nderon familjen Jashari

GJAKOVË, 7 MARS (ER) - Një delegacion nga Komuna e Gjakovës, i kryesuar nga nënkryetari Ramadan Hoti, ka bërë homazhe dhe ka vendosur kurora me lule në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, në nderim të përvjetorit të rënies heroike të familjes Jashari. Siç ka njoftuar Komuna e Gjakovës, Hoti ka thënë se sakrifica e familjes Jashari është dëshmia më e mirë e peshës që ka liria dhe shtetësia e Kosovës. "Nder e respekt i përjetshëm për familjen Jashari dhe të gjithë heronjtë e dëshmorët e Kosovës!", ka njoftuar Komuna e Gjakovës.

Bekim Jashari: Dita e Mësuesit, kujtesë e veçantë për babën Shaban

SKENDERAJ, 7 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka uruar të gjithë mësimdhënësit me rastin e 7 Marsit, Ditës së Mësuesit. Ai ka thënë se kjo ditë është e veçantë edhe për gjyshin e tij, Shaban Jashari, i cili ka rënë heroikisht gjatë betejës së 5, 6 dhe 7 marsit të vitit 1998 në Prekaz. "Gëzuar 7 Marsi, Dita e Mësuesit! Në këtë ditë të shënuar kujtojmë me nderim përkushtimin e mësuesve dhe arsimdashësve që me sakrifica të mëdha kanë zhvilluar arsimin kombëtar, duke kontribuar në arsimimin e armatës së shkollarëve tanë, arritjen e dijes dhe vlerave arsimore. Kjo ditë është kujtesë e veçantë për babën Shaban, por edhe të gjithë mësuesit që me dashuri të pashoqe kanë kontribuar për arritjen e dijeve dhe arsim në pajtim me kulturën kombëtare në rrethana të rënda. Urime Dita e Mësuesit!", ka shkruar Jashari në llogarinë e vet në "Facebook".

Bahtiri: Do të kërkoj nga MAShT-i ndërtimin e shkollës për nxënësit e 'Nonda Bulka'-s

MITROVICË, 7 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur në takim një grup nxënësish të Shkollës Fillore "Nonda Bulka", për t'i parë nevojat që kanë ata gjatë zhvillimit të procesit mësimor. Në këtë takim me mësimdhënësen Shukrije Breznica dhe nxënësit e kësaj shkolle, Bahtiri ka dëgjuar për problemet me të cilat janë duke u përballur ata. Mësimdhënësja Shukrije Breznica e ka falënderuar kryetarin Bahtiri për kohën që ka gjetur për t'i dëgjuar kërkesat e nxënësve të asaj shkolle. Ajo ka thënë se nxënësit e saj janë të shkëlqyeshëm si në mësime, po ashtu edhe në sjellje, por ajo që e brengos atë është krijimi i një shkolle të re, pasi objekti i tyre ndodhet në pjesën veriore. Edhe nxënësit janë shprehur falënderues ndaj kryetarit Bahtiri për praninë e tij në takim dhe për mbështetjen që po ua jep të gjithë qytetarëve në Mitrovicë, sidomos për dashurinë dhe ndihmën që ua dhuron fëmijëve.

Ndërsa kryetari i Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka thënë se është shumë i kënaqur për praninë e fëmijëve në zyrën e tij. "Ju falënderoj shumë për pjesëmarrje dhe për kërkesat që parashtruat. Ne si komunë çdoherë bëjmë përpjekje maksimale për sigurimin e kushteve të nevojshme për nxënësit në shkolla. Unë do t'i bëj një kërkesë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MAShT), për ndërtimin e një shkolle për nxënësit e 'Nonda Bulkës' dhe për kushte të nevojshme për mbarëvajtjen e mësimit", ka thënë Bahtiri, duke i uruar të gjithë mësimdhënësit për 7 Marsin - Ditën e Mësuesit.

Komuna e Suharekës do të bëhet me objekt të ri

SUHAREKË, 7 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka bërë me dije se brenda dy vjetëve kjo komunë do të bëhet me objekt të ri. Ai ka thënë se ky objekt do të financohet nga Komuna e Suharekës dhe Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal (MAPL). "Suhareka do ta ketë objektin e ri të komunës me shumë shërbime të avancuara dhe me sallën e Asamblesë Komunale. Sot kam nënshkruar marrëveshjen e bashkëfinancimit me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) për objektin e ri i cili do të ndërtohet brenda dy vjetëve. Në vitin 2019 MAPL-ja financon me 500 000.00 euro, ndërsa komuna jonë me 50 000.00 euro. Në vitin 2020 MAPL-ja financon me 850 000.00 euro, ndërsa komuna jonë me 200 000.00 euro. Urime të gjithëve!", ka deklaruar Muharremaj.

USHTRIA ÇLIRIMTARE KISHTE STRATEGJI, ÇLIRIMIN E KOSOVËS

Nga Jakup KRASNIQI

Në luftën e Prekazit u vranë 58 (62) shqiptarë, fëmijë, gra, pleq e të rinj dhe kjo qe një humbje e madhe për tërë kombin, e sidomos për Drenicën e Jasharët. Llogaria që bëri armiku doli e gabuar, sepse radhët e UÇK-së po shtoheshin në mënyrë marramendëse. Populli, e sidomos rinia, po bindej gjithnjë e më tepër se nderi e dinjiteti i kombit e i Atdheut do të mbrohej vetëm me luftë të armatosur e jo me përulje prej zvarraniku. Lufta veç kishte filluar. Pushka ka qenë ajo që gjithherë kishte mbrojtur nderin dhe dinjitetin e njeriut e të kombit. As në luftën që nisi në Likoshan, Qirez dhe Prekaz s'mund të pritej diçka tjetër. Vrasja e komandantit legjendar, sakrifica kolektive e tre brezave të Jasharëve (Shaban Jashari, Ademi dhe Kushtrimi, ishin: gjyshi, Shabani me të birin, Ademin dhe nipin, Kushtrim Ademin, tre breza njëherësh ranë me pushkë në dorë për Kosovë), hapi një epokë të re të lavdisë, të tragjedisë e të madhështisë në historinë tonë më të re. Lufta për liri hyri në një rrugë të pa kthim dhe do të vazhdojë deri në fitore. Shqiptarët e fituan jo vetëm lirinë, por në rrugën e shtetndërtimit e fituan edhe botën demokratike. Bota shpejt u bind për vendosmërinë e shqiptarëve, për pathyeshmërinë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila po njihte vetëm ngritje. Adem Jashari u bë legjendë e përjetësisë. Ora e Kosovës kishte ardhur. Frika ishte mundur, vështirësi do të kishte, po fitorja ishte e pashmangshme. Vetëm tradhtarë e frikacakë dhe mohuesit e luftës çlirimtare kishin frikë nga liria. Liria po vinte për të gjithë. Më të guximshmit nuk hezituan t'i hapin flatrat si shqiponja për t'i dalë zot Atdheut në kohë furtunash të rrezikshme. Furtuna e luftës kaloi, por pas furtuna nuk u menaxhua si do të duhej menaxhuar!!!

Duhet të themi se mënyra se si u organizua sulmi mbi Prekaz dhe fshatrat përreth, e sidomos me seriozitetin dhe përmasat e zjarrit që përdori armiku, bënë që të gjendej e befasuar dhe e papërgatitur Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Ajo jo vetëm se u gjet e befasuar, por edhe nga mënyra se si u pozicionua armiku e bëri të pamundshme shkuarjen në ndihmë forcave të UÇK-së që ndodheshin të rrethuara në Prekazin e Poshtëm. Zjarri ushtarak që përdori armiku ato ditë ishte i përmasave të mëdha dhe kishte qëllim zhdukjen e themeluesve të UÇK-së dhe të qëndresës shqiptare, që ishin të përqendruar në Prekazin e Poshtëm. Armikut hesapet i dolën të gabuara, themeluesit e ushtrisë çlirimtare gjendeshin kudo ku kishte shqiptarë si në Kosovë, po ashtu edhe në diasporë. Ushtria Çlirimtare e Kosovës kishte siguruar vazhdimësinë dhe pavdekësinë e saj. Rënia e tre brezave luftëtarë të Jasharëve çelikosi themelet e UÇK-së dhe të Kosovës. Flijimi biblik i Jasharëve e mobilizoi gjithë kombin shqiptar, kudo ku ai ndodhej. U organizuan demonstrata brenda dhe jashtë atdheut, kudo u brohorit: "Gjithë shqiptarët janë UÇK"! Nëse aty-këtu pati shenja dobësie të UÇK-së për t'i shkuar në ndihmë komandantit legjendar, ajo dobësi do të kthehej në guxim e vendosmëri për ta vazhduar veprën jetësore të Adem Jasharit - çlirimin e Kosovës, krijimin e shtetit të pavarur, sovran dhe demokratik si dhe hapjen e të gjitha perspektivave për t'u bërë pjesë e botës demokratike. Pas luftimeve në Likoshan e Prekaz, pas masakrave mbi popullsinë duarthatë, ShP i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës detyrohet ta analizojë strategjinë e veprimit ushtarak. Lufta Guerile e tipit "sulmo e zhduku" nga vendi i ngjarjes u tregua e dëmshme, sepse armiku po hakmerrej në mënyrën më kriminale mbi popullsinë civile, mbi gra, pleq dhe fëmijë. Lufta guerile pa dyshim që i konvenonte shumë UÇK-së (ani pse shumë luftëra guerile kanë mbetur brenda atij pragu dhe nuk kanë fituar për faktin se nuk janë shndërruar në ushtri vullnetare me karakter popullor, kujto IRA-në dhe ETA-në etj.). Kalimi i UÇK-së nga guerilja në njësitë e ushtrisë vullnetare ishte domosdoshmëri dhe këtë domosdoshmëri e imponuan nga masat barbare që i ndërmerrte regjimi kriminel i Beogradit. Barbaria e armikut u tregua në Likoshan, Qirez, Prekaz të Poshtëm etj. Mënyra e luftës që u imponua nga Serbia dhe gatishmëria e UÇK-së për t'u përballur edhe frontalisht me makinerinë ushtarake serbe e bëri të suksesshme UÇK-në. Nuk ka asnjë dyshim, Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte ushtri vullnetare e popullit të Kosovës. Ia vlen ta themi se Adem Jashari - komandanti legjendar i UÇK-së, nuk ka qenë ithtar i luftës guerile, por vetëm pas Epopesë së UÇK-së të marsit 1998 është përdorur forma e luftës që ka preferuar Adem Jashari. Madje edhe 5, 6 e 7 marsi nuk e kishte asnjë element të luftës guerile. Ndërsa qëllimi i armikut ishte: që UÇK-ja mos të mbështetej nga populli shqiptar, kjo ishte edhe një arsye shtesë pse ushtria e policia serbe hakmerrej mbi popullsinë civile. Por qëllimi i parësor i Serbisë ishte zhdukja e plotë ose pjesërisht e popullit shqiptar të Kosovës. Situata e krijuar, shkalla e lartë e luftimeve dhe rrezikimet e mëdha për popullsinë civile, e shtrojnë domosdoshmërinë para ShP të UÇK-së, ngritjen e përgjegjësisë disiplinore dhe organizative. Ndër detyrat më kryesore ishin:

- Zgjerimi i ushtrisë me njerëz të rinj e të guximshëm;
- Sigurimi i armëve sa më të sofistikuara për luftën;
- Zgjerimi i ushtrisë, fillimisht në fshatrat që kishin një mbrojtje strategjike;
- Ngritja e llogoreve të luftës do të thoshte heqje dorë nga lufta guerile;
- Krijimi i sa më shumë territoreve të lira dhe
- Në mesin e vitit 1998 u kalua në formacione ushtarake deri në brigada.

Të përfundojmë: Këto ishin fazat e strategjisë ushtarake të ShP të UCK-së, ndonjë strategji a doktrinë tjetër individualiste nuk ka ekzistuar a propozuar, e as që është kundërshtuar deri në përfundim të luftës çlirimtare. Pas luftërave çlirimtare, praktika të shumta në botë kanë treguar e tregojnë, tregon edhe praktika jonë se si shtohet numri i luftëtarëve (veteranëve) e, pse jo, edhe i gjeneralëve e doktrinarëve, mund të shtohen edhe strategji e strategë të ndryshme të ri, pse jo. Më e rëndësishmja është se me dobësi e suksese politike dhe ushtarake, me ngritje e rënie, Kosova fillimisht fitoi aleatë të shumtë. Pa dyshim, më kryesori ishte Aleanca Veriatlantike - NATO, me të cilën së bashku arritëm ta çlirojmë Kosovën nga pushtuesi më 21/22 qershor 1999, kur e tërë makineria armike u largua nga Kosova, pastaj më 17 shkurt 2008 përfaqësuesit e zgjedhur të popullit të Kosovës e shpallën pavarësinë dhe sovranitetin e Republikës së Kosovës. Kështu u realizua strategjia e çlirimit të Kosovës!

Çdo luftë lë pas vetes edhe të pakënaqurit e hatermbetësitë e saj. Po kjo është çështje tjetër. E pakënaqur është edhe Serbia dhe kjo është mirë!

Kryesia e LDK-së bën homazhe në Prekaz

Skenderaj, 7 mars (ER) - Anëtarë të Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), kryetarë të degëve dhe aktivistë, kanë bërë homazhe te Kompleksi Memorial në Prekaz dhe kanë vizituar familjen Jashari. Në emër të kryesisë, sekretari i përgjithshëm i LDK-së, Ismet Beqiri, ka falënderuar Rifat Jasharin për pritjen. Beqiri ka vlerësuar lart veprën sublime të familjes Jashari, e cila bëri ndryshime në historinë e kombit shqiptar. Ai ka thënë se familja Jashari dha gjithçka për këtë vend. Rifat Jashari ka falënderuar anëtarët e Kryesisë së LDK-së dhe ka kërkuar bashkim nga e gjithë skena politike për të ndërtuar dhe zhvilluar shtetin tonë. Jashari, gjithashtu, ka shprehur interesim për shëndetin e kryetarit Mustafa dhe i ka uruar shërim të shpejtë.

E jashtëzakonshme

Zbulohen tri lloje të reja merimangash

Popullsia e merimangave në Australi ka mirëpritur edhe shtimin e tri llojeve të reja të vogla, plot ngjyra, krejtësisht të padëmshme. Speciet e zbuluara rishtazi të merimangave pallua, të cilat banojnë në Australinë Perëndimore, u quajtën zyrtarisht të mërkurën specie të reja. Të emëruar nga taksonomisti i merimangave, Joseph Schubert, speciet e reja tani njihen si

Maratus aquilus, Maratus felinus dhe Maratus combustus, të cilat identifikohen sipas modeleve të tyre dalluese.

FOTO E DITES

Një polic i Indonezisë shihet në një aksion të shkatërrimit të bimëve të marijuanës. /AFP

E rrallë

Sfida e nxënësve tri ditë pa celularë

Të heqësh dorë në mënyrë vullnetare për tri ditë nga celulari, 72 orë pa biseduar, pa postuar fotografi në "Instagram" dhe pa shfletuar në murin e "Facebook"-ut, kjo është sfida që u është dhënë nxënësve të shkollave të mesme të Vignola, Pavullo dhe Castelnuovo, në zonën e Modenese në Itali. Kësaj sfide i janë bashkuar 450 të rinj. Çudia ishte se disa prindër refuzuan

që fëmijët e tyre t'i bashkohen këtij eksperimenti sepse nuk mund t'i kontaktonin.

BARSOLETA E DITËS

A e dini se si i jep bakshish gjakovari muzikës?
E tërheq kartën e kreditit nëpër harmonikë.

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers



Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI Nëse nuk keni provuar gjithçka, sot do të merrni një hap të rëndësishëm për t'i zhvilluar raportet tuaja personale dhe profesionale.

DEMI Keni treguar që jeni mjaft sipërfaqësore në përzgjedhjen e raporteve afektive kohët e fundit. Nëse nuk doni të lëndoheni, merrni masa.



BINJAKËT Dilemat tuaja sot do t'ia lënë vendin sigurisë që do t'ju japë partneri në hapat që keni pasur mjaft problem për të ndërmarrë.

GAFORRJA Sot nuk mund t'i rezistoni një tavoline të shijshme që jeni ftuar. Edhe pse keni vendosur të kujdeseni për pamjen tuaj, sot do të devijoni nga dieta.

LUANI Nëse doni të arrini diçka sigurisht se ju i dini të gjitha mënyrat për t'ia arritur qëllimit. Ajo që keni zgjedhur të bëni nuk është shumë korrekte.

VIRGJËRESHA Po i jepni kohë vetes të filloni t'i shijoni çastet që ju ofron dita. Nga ngarkesa që keni pasur shumë gjëra kanë kaluar pa u vënë re.

PESHORJA Duhet të impenjoheni shumë më tepër se zakonisht për ta arritur synimin tuaj sot. Ia keni vënë vetes një detyrë të vështirë që duhet ta realizoni.

AKREPI Personat me të cilët po bashkëpunoni i keni kundërshtarë në çdo hap dhe ide tuajën. Gjithsesi duhet të përpiqeni të jeni në një mëndje në përfundim.

SHIGJETARI Jeni të bindur që gjithçka sot varet nga humori dhe shpirti i iniciativës që do të keni. Do t'i gjeni personat e duhur që mendojnë si ju.

BRICJAPI Nuk keni qenë shumë në dijeni të zhvillimeve të fundit me miqtë tuaj dhe sot do të bëni një gafë që njëri prej tyre nuk do ta pëlqejë.

UJORI Sot nuk jeni shumë entuziast se çfarë po ndodh rreth jush. Në mbrëmje do të kërkoni të rrini të qetë në ambient familjar.

PESHQIT Nëse doni ta kaloni ditën në mënyrë konstruktive duhet të filloni të programoni çdo gjë. Hiqni dorë nga gjithçka tjetër që ju pengon.



Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	JUVENTUS - UDINESE	1-1	BREMEN - SCHAKE	2	BILBAO - ESPANYOL	1

Ademi: Gramoz Vokrri i refuzoi disa pozita në FFK. Derën e ka të hapur

Kryetari i Federatës së Futbollit, Agim Ademi, ka konfirmuar se Gramoz Vokrri ka refuzuar disa pozita në FFK, por për të dera e Federatës do të jetë gjithmonë e hapur. Në lidhje me akuzat e skuadrës së Llapit, që FFK-ja i ka ofruar skuadrës së Prishtinës 38 mijë euro, Ademi ka thënë se nuk qëndrojnë dhe klubet marrin vetëm shumat që iu takojnë

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 7 MARS - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, të enjten e ka mohuar se e ka larguar nga puna djalin e legjendës Fadil Vokrri, Gramoz Vokrrin. Numri një i FFK-së ka thënë se Gramozi gjithmonë e ka të hapur derën e Federatës së Futbollit por, sipas Ademit, djali i legjendës nuk e ka pranuar pozitën e Drejtorit për Marrëdhënie me Jashtë. "Gramozi është anëtar yni dhe është i mirëpritur në Federatë. Këtë nuk e kemi bërë për ndonjë përvojë që e ka, por që është djali i legjendës Fadil Vokrri, të cilin e respektojmë maksimalisht, por edhe si një djalë i ri që është rritur në Evropë, i cili mund të japë rezultat në Federatë. Ne ia kemi ofruar një kontratë të re, por ai nuk ka pranuar ta nënshkruajë, për arsye të cilat ne nuk i dimë. Atij i është ofruar pozita e drejtorit për marrëdhënie me jashtë, por ka disa ditë që nuk është duke ardhur dhe nuk na ka dhënë përgjigje", ka thënë Ademi, i cili ka konfirmuar se Gramoz Vokrrit i janë ofruar edhe disa pozita të tjera si drejtor i edukimit, i marketingut, i regjioneve dhe i garave, por asnjërën prej këtyre pozitave nuk e ka pranuar. Gazeta merr vesh se kërkesa e Gramoz Vokrrit ka qenë pozita e drejtorit gjeneral. Në konferencën e mbajtur të enjten kryetari Ademi foli edhe për akuzat që i ka bërë ditë më parë skuadra e Llapit, se FFK-ja e ka ndihmuar Prishtinën me 38 mijë euro për ta mposhtur Llapin në derbin e javës së 20. Ademi i ka quajtur të pavërteta akuzat e Llapit, duke thënë se klubet i marrin vetëm shumat që iu takojnë dhe asnjë cent më shumë. "Jemi me të gjithë Komitetin këtu për ta sqaruar se ajo shumë, 38 mijë euro, nuk qëndron. Klubet marrin vetëm ato para që u takojnë nga Federata e Futbollit. Asnjë cent më shumë. Ne do t'u ndihmojnë të gjitha klubeve aq sa kemi mundësi. Superliga i ka pagesat e të drejtës televizive që i transmeton ndeshjet, që i kanë të rregullta, si dhe i kanë paratë e sponsores - IPKO-s. Secili klub i merr në baza të barabarta. Të gjithat pagesat do të verifikohen sepse të gjitha bëhen përmes bankës. Kontratat me 'Digitalbin' çdo klub i ka nënshkruar në fillim të sezonit. Ne nuk kemi ndikim aty, por jemi për t'iu ndihmuar. Për këtë arsye, kur klubet kanë nevojë t'i marrin këto para më herët, ne ua japim më herët, siç ka ndodhur me 7 apo 8 klube këtë sezon", ka thënë Ademi, duke shtuar:

"Edhe klubet të cilat shkojnë në garat e UEFA-s, Ligës së Evropës dhe Ligës së Kampionëve, ne ua japim paratë më herët për t'iu ndihmuar. Ndërsa 8 000 euro i janë dhënë Prishtinës për akademinë e futbollit. Kjo shumë u jepet të gjitha klubeve dhe është projekt i UEFA-s".

Sot fillon shitja e biletave për ndeshjet ndaj Danimarkës dhe Bullgarisë

Zëvendësekretari i përgjithshëm i Federatës së Futbollit të Kosovës, Arianit Ahmeti, ka bërë me dije se biletat për ndeshjen kundër Danimarkës dhe Bullgarisë do të dalin në shitje të premten. "Biletat do të shiten sërish nëpërmjet platformës online, kurse çmimet e biletave kanë pak rritje në krahasim me ndeshjet e kaluara, në bazë të marrëveshjes së zyrës së marketingut të FFK-së me të gjitha zyrat e marketingut të federatave të regjionit, për të cilën është pajtuar edhe UEFA. Në veri dhe jug biletat do të kushtojnë 5 euro, kurse në lindje, dy pjesët anësore, do të jenë nga 10 euro, kurse pjesët e tribunës qendrore 15 euro. Në perëndim, pjesa e poshtme, 15 euro, kurse pjesa sipër, përkrah tribunave VIP, do të kushtojë 20 euro. Ndërkaq, biletat VIP do të jenë 80 euro", ka thënë Ahmeti. Kosova ndeshjen miqësore ndaj Danimarkës e zhvillon më 21 mars, kurse kualifikuesen ndaj Bullgarisë e zhvillon katër ditë më vonë.

Gramoz Vokrri: Nuk jam pjesë e federatës, Agim Ademi po e shkatërron FFK-në

Djali i Fadil Vokrrit, Gramozi, po pretendon se Agim Ademi e largoi nga Federata, me arsyen se nuk është pajtuar me 'urdhrat' e tij. Sipas Gramoz Vokrrit, Ademi është duke e shkatërruar atë që e ngriti më shumë mund legjenda e futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri

Liridon ZEQIRI

PRISHTINË, 7 MARS - Djali i legjendës së futbollit dhe kryetarit tashme të ndjerë të FFK-së, Fadil Vokrrit, Gramoz Vokrri, ka konfirmuar se nuk është pjesë e Federatës së Futbollit të Kosovës. Ai e ka akuzuar kryetarin aktual të FFK-së, Agim Ademin, se po e shkatërron atë që e ngriti babai i tij, Fadil Vokrri. "Ka mbi 45 ditë që nuk jam pjesë e strukturave të FFK-së pas një periudhe gjashtëmujore pa kontratë e as pozitë. Unë kam heshtur. Largimin tim nga Federata e Futbollit të Kosovës nuk e kam bërë publik për opinionin sepse nuk kam dashur që në FFK të këtë turbulencë, por kam dashur ta ruaj autoritetin, integritetin dhe reputacionin e Federatës së Futbollit të Kosovës të cilin me shumë mund e ngriti Fadil Vokrri dhe

bashkëpunëtorët e tij të vërtetë, ndërsa Agim Ademi po e shkatërron", ka thënë Gramoz Vokrri, i cili mbetet i befasuar edhe me konferencën e mbajtur lidhur me largimin e tij nga Federata e Futbollit.

Gramoz Vokrri e ka akuzuar Ademin se ende pa përfunduar e pamja e babait, Fadilit, kishte filluar mbledhjen e nënshkrimeve për të qenë pasardhës i tij në FFK. "Kam heshtur edhe atëherë kur ende pa përfunduar varrimi dhe e pamja për babanë, tashmë kryetari i FFK-së, Agim Ademi, kishte filluar mbledhjen e nënshkrimeve për postin që ka. Ai kishte premtuar se do ta vazhdojë vizionin dhe frymën e Fadil Vokrrit, por sot me keqardhje iu them se FFK-ja është shndërruar në përndjekës të bashkëpunëtorëve të Fadil Vokrrit dhe për mua më shqetësues ishte fakti se ai pretendonte që në rast mospajtimi, do t'i shkarkonte të gjithë. Mostransparenca financiare dhe tendencat në referim nuk kanë qenë asnjëherë vizioni i Fadil Vokrrit për futbollin e Kosovës. Agim Ademi më largoi nga FFK-ja për shkak se e kundërshtova. Nuk u pajtova me abuzimet dhe mënyrën e udhëheqjes së tij. Sinqerisht më vjen keq për nivelin e disa anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv, dikur 'miqbashkëpunëtorë' të babit tim, për nënshtrimin dhe nënçmimin që ata po ia bëjnë vetes dhe Federatës së Futbollit të Kosovës, të rreshtuar krah Agim Ademit. Pavarësisht ku do të më dërgojnë dallgët e jetës, në Federatë apo diku tjetër, zemra ime dhe familjes time do të rrahë bashkë me zemrën e futbollistëve të Kosovës, për t'i përjetuar emocionet që ata na sjellin të gjithëve", ka shtuar Gramoz Vokrri.

Sot derbi i Media Ligës "Epoka e re" - "Media Works"

Prishtinë, 7 mars - Një nga ndeshjet më interesante në këtë edicion të Media Ligës zhvillohet sot (e premte) nga ora 17:00. Takohen "Epoka e re" dhe "Media Works". Aktualisht këto dy ekipe ndajnë dy pozitat e para dhe janë favorite për ta fituar titullin e më të mirit. Aktualisht "Epoka e re" ka tri pikë më shumë dhe epërsinë e golave nga ndeshja e parë ku kishte triumfuar me rezultat 8-1, por forma e mirë e "Media Works"-it mund të ndryshojë rezultat. Ekipi i tretë në tabelë, "Klan Kosova", kërkon fitore ndaj "RTV Dukagjinit" dhe pret që të afrohet në tabelë me dy skuadrat e para. Ndeshje interesante do të jetë edhe në mes "Telegrafit" dhe "Infokusit", kurse në ndeshjet e tjera takohen: "Lajmi.net"-"Kallxo.com", "D+"-"Gazeta Zëri", "Ora Info"-"Gazeta Metro", "Info Kosova&Prishtina Post"-"RTK", "Gazeta Blic"-"KosovaPress".



Historia interesante e futbollistit Bashkim Ajdini

PRISHTINË, 7 MARS - Futbollisti Bashkim Ajdini ka një histori interesante. Ai është me prejardhje nga Ternoci, kurse ka lindur më 10. 12. 1992 në Halmstad të Suedisë. Futbollisti në fjalë për dhjetë vjet e ka bartur mbiemrin Renneke, pasi ka jetuar në Gjermani pa familje dhe mbiemri ishte për shkak të trajnerit të Bashkimit, i cili e ka sjellë në Gjermani nga Ternoci dhe e kishte mbikëqyrur për disa vjet. "Tash jam tepër i gëzuar dhe krenar që barti në fanellë mbiemrin tim të vërtetë", ka thënë ai. Ajdini është futbollist profesionist në Ligën e Tretë të Gjermanisë dhe bartë fanellën me numër 7 në klubin e VFL-Osnabruck, i cili është në pozitën e parë dhe ka të gjitha shanset për t'u ngritur në Bundesliga 2. Bashkimi është një lojtar që mund t'i luaj disa pozicione të ndryshme, por pëlqen mesfushor i krahut.

Anulohen ndeshjet e Kategorisë Superiore në Shqipëri

TIRANË, 7 MARS - Pasi njoftoi të gjithë klubet e futbollit për moszhvillimin e ndeshjeve të fundjavës, Federata Shqiptare e Futbollit doli me një qëndrim zyrtar në mbështetje të vendimit të Shoqatës së Gjyqtareve për bojkotin e kampionatit si reagim për dhunën e ushtruar ndaj gjyqtarit Eldorian Hamiti. "Federata Shqiptare e Futbollit ju bën me dije se të gjitha ndeshjet e kampionatit kombëtar të futbollit të planifikuara këtë fundjavë nuk do të zhvillohen, si rrjedhojë e vendimit të marrë nga Bashkimi i Arbitrave Shqiptarë të Futbollit (BAShF), për t'i bojkotuar të gjitha ndeshjet deri në rikthimin e Policisë së Shtetit në stadiume", thuhet në njoftim. "FShF shpreh mbështetjen maksimale ndaj të gjithë trupës arbitrale në Shqipëri dhe vlerëson e respekton vendimin e marrë prej saj. Ne kërkojmë reagimin e të gjithë aktorëve për ta larguar përfundimisht dhunën, për ta garantuar rendin dhe sigurinë publike në stadiume, si parakushti themelor për të pasur një garë të shëndetshme dhe brenda standardeve", thuhet në njoftimin e FShF-së.

Lakersat dhe Jamesi nuk shohin dritë

Los Angeles, 7 mars - Los Angeles Lakers dhe LeBron James nuk kanë çfarë bëjnë përballë makinerisë Denver Nuggets, që iu gëzua fitores me rezultatin 99-115. "Mbreti", pavarësisht prej 31 pikëve të shënuara, nuk ia doli dot ta çonte drejt suksesit skuadrën e tij. Kështu Lakers e shohin veten edhe më larg fazës së "play-off"-it. San Antonio Spursi ka bërë detyrën kundër Atlanta Hawksit, teksa ka triumfuar me rezultatin 104-111. LaMarcus Aldridge ishte lideri i skuadrës së tij me 32 pikë të realizuara. Chicago Bulls ka befasuar Philadelphia 76ers, pasi e mundi 108-107. Zach LaVine ishte i papërmbajtshëm me 39 pikët e realizuara. Detroit Pistons ka marrë një fitore me vlera kundër Minnesota Timberwolvesit. Kjo sfidë u mbyll me rezultatin 131-114. Andre Drummond ishte në formë, pasi shënoi 31 pikë dhe rikuperoi 15 topa. Gjithashtu, edhe asistoi tri herë. Paraqitje e mirë edhe nga Luke Kennard, autor i 21 pikëve. Boston Celticsi nuk e ka ndalur marshimin dhe këtë herë ka likuiduar 109-111 Sacramento Kingsin dhe ka marrë fitoren e 40 sezonale. Fitore edhe për Utah Jazzin, që kaloi me sukses New Orleans Pelicansi, në një përballje që përfundoi 104-114.

REZULTATET

Charlotte H.-Miami H.	84-91
Washington W.-Dallas M.	132-123
Detroit P.-Minnesota T.	131-114
Brooklyn N.-Cleveland C.	113-107
Atlanta H.-San Antonio S.	104-111
Chicago B.-Philadelphia 76ers	108-107
New Orleans P.-Utah Jazz	104-114
Phoenix Suns-New York K.	107-96
Sacramento K.-Boston Celtics	109-111
LA Lakers-Denver N.	99-115

SHKURT

Mavraj nga "ferri" grek në "parajsën" gjermane

Mërgim Mavraj duket se po kthehet në një lider të padiskutueshëm në kategorinë e dytë gjermane, te skuadra e Ingolshtadit. Mbrojtësi shqiptar, në ndeshjen e fundit që ekipi i tij ka luajtur me Këlnin, është shpallur lojtari më i mirë i ndeshjes për skuadrën e tij. Ekipi gjerman hapi një sondazh për ta zgjedhur lojtarin më të mirë të kësaj sfide dhe mbrojtësi shqiptar nuk ka zhgënjyer. Tashmë, sa po duket, Mavraj është afër marrjes së shiritit të kapitenit. Gjendja e tij është shumë e mirë, por ekipi po lufton për të mos rënë në kategorinë e tretë. Shqiptari ka harruar "ferrin" grek tek Arisi dhe po ndihmon skuadrën e tij në objektivat e vendosur.

Solskjaeri: Besuam në kualifikim

Trajneri i Manchester Unitedit, Ole Gunnar Solskjaer, ka thënë se klubi i tij ka besuar se mund ta përmbyste humbjen e ndeshjes së parë me Paris Saint-Germainin për të kaluar në çerekfinale të Ligës së Kampionëve. "Djajtë e Kuq" ishin mposhtur 0-2 në shtëpi, por fituan 1-3 si mysafirë të PSG-së për të shkuar tutje me përmbysje dramatike. "E dinim gjithmonë se kjo ishte e mundshme. Ky është klubi. Kjo është ajo që bëjmë ne. Ky është Manchester Unitedi. Dy të rinjtë Chong dhe Greenwood që hynë në lojë na dhanë më shumë energji kur na duhej goli", ka thënë Solskjer.

Silva: Ky është futbolli, u kërkoj tifozëve që të na falin

Kapiteni i PSG-së, Thiago Silva, nuk gjen fjalë për ta përshkruar zhgënjimin e skuadrës franceze pas përmbysjes dramatike nga Manchester Unitedi. "E kam të vështirë që të flas. Është turp. Luajtëm shumë mirë në Manchester, por nuk i bëmë gjërat që kishim diskutuar përpara ndeshjes. Ishim në një formë shumë të mirë, por përsëri përfundon këtu aventura jonë në Evropë. Ky është futbolli. Asgjë nuk funksionoi në këtë ndeshje. U kërkoj tifozëve të na falin", ka thënë qendërmbrojtësi brazilian. "Por edhe pse jemi të trishtuar, duhet të vazhdojmë përpara, kemi kampionatin. Është një moment trishtimi. Penalltia? Më vjen keq sepse ndodhi në fund të ndeshjes. Nuk i pashë pamjet, por ishte një vendim i dyshimtë. Por tre gjyqtarë vendosën kështu dhe e pranojmë. Duhet ta kishim mbyllur më parë", ka shtuar Silva.

Bayerni e kërkon Dybalan

Bayern Munchen pritet të përforcohet fuqishëm në afatin kalimtar të verës. Mediet gjermane raportojnë se kjo skuadër ka arritur marrëveshje me Hernandezin, Pavardin dhe Wernerin. Ndërsa sot "Corriere Dello Sport" ka zbuluar se Bayerni pritet të bëjë ofertë edhe për yllin e Juventusit, Paulo Dybala. Dybala e ka humbur shkëlqimin te Juve që prej transferimit të Cristiano Ronaldos, por realizmi i këtij transferimi duket problematik për faktin se "Zonja e Vjetër" kërkon 120 milionë euro.

Messi rikthehet tek Argjentina

Leo Messi është grumbulluar me kombëtaren argjentinase për miqësoret e ardhshme që bardhekaltrit do të luajnë kundër Venezuelës dhe Marokut. Numri 10 i Barcelonës nuk ka luajtur me përfaqësuesen që nga Kupa e Botës 2018. Më saktësisht, "Pleshti" do të kthehet të luajë me kombëtaren pas 250 ditësh.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Komuna Dragash/Opštine Dragaš / Daragas Municipality

Mbështetur në Nenin 5, pika c, të Ligjit nr.03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, si dhe nenin 8 pika 1,2 të Ligjit të punës Nr.03/L-212 dhe kërkesave tëdrejtorit të DKA-së në Dragash me nr.02.111/2-4326 dhe nr.02.111/1-4331,aprovimit nga kryetari I Komunes së Dragash-it Shërbimi I Personelit K.Dragash shpallë:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës:

• Dy punëtor ;
Nje punëtor teknik-Fokist në SHFMU"Shaban Shabani " në Llopushnik K.Dragash dhe
Një punëtor teknik-pastrues në SHFMU "25 Maji në fsh.Vraniq K.Dragash

- **Niveli i pages;Për punëtor teknik-Fokist K;4.5 për punetor teknik- pastrues K 4**
- **Periudha e kontrates;**12 muaj me mundësi vazhdimi
- **Orct e puncs;**40 ore në javë
- **Pergjegjes mbikqyrës ;d**rcjtori i shkollcs

Kushtet për punëtor teknik :

Kandidatët e interesuar për të konkurruar për vendin e punës, **Punëtor teknik-pastrues** duhet t'i plotësojnë këto kushte:

Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës

Të kenë të kryer shkollen e mesme .

Te kenë pervojë pune 6 muaj

Detyrat e punës për punëtor teknik-fokist dhe pastrues, do të caktohen me kontratë të punës.
Aplikacionet merren në zyrën e Personelit –K.Dragash.
Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet: Letërnjoftimi, ekstrakti i lindjes, diploma fotokopje e vërtetuara te noteri.
Dokumentet e pa kompletuara nuk merren në shqyrtim.
Afati i konkurrimit **është 15 ditë** nga dita e publikimit në gazet.

Sherbimi I Personelit
Dragash

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës 03/L-212, Neni 3 i Rregullores për marrëdhënien e punës 01-2991/14, Neni 4 i Udhëzimit Administrativ nr 07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Telekomi i Kosovës Sh.A shpall:

KONKURS PUBLIK PËR VENDE PUNE

Titulli i vendit te punës
1. Zyrtar Ligjor (2- ekzekutues)
2. Zyrtar për Burime Njerezore (2-ekzekutues)

Vendi i Punës: Prishtinë
Data e hapjes: 08.03.2019
Afati i fundit për aplikim: 22.03.2019 në ora 16:00

1. Zyrtar Ligjor (2 ekzekutues)
Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Përfaqëson Telekomin e Kosovës pranë organeve kompetente me autorizim të drejtorit të departamentit. Përgatitë dhe mirëmban dosjet e konsumatorëve të paditur. Përgatitë dhe përpunon dokumentacionin për ngritjen e padive.
Përcjell pagesat e konsumatorëve nga gjykata, bashkëpunon ngushtë me departamentet e TK-së. Është përgjegjës për të përgatitur lëndët për përfaqësim gjyqësorë. Me kërkesë të udhëheqësit përgatitë vendime, shkresa, parashtresa për kompaninë. Interpreton dhe mbanë përgjegjësi për të gjitha interpretimet ligjore që kërkohen nga personeli i kompanisë. Përgatit kontrata, marrëveshje dhe dokumente tjera ligjore me të cilat sigurohet administrim efektiv. Ndërmerr veprime ligjore brenda autorizimeve dhe përgjegjësive të deleguara; Përgatitë raporte dhe evidenca lidhur me kryerjen e punëve brenda përgjegjësive të Departamentit Juridik;
Kryen edhe punë të tjera ligjore që i ngarkohen nga udhëheqësi në departamentin ligjor

Kualifikimi, përvoja dhe te tjera:

Diplomë universitare në fushën e drejtësisë. Njohje e ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
Dy (2) vite përvojë pune në profesion, aftësi të mira komunikimi, të ketë aftësi për punë në grup. Gatishmëri për të punuar me orar më të gjatë se orari i rregullt i punës. Njohuri nga puna me kompjuter, preferohet njohja e mirë e gjuhës angleze në të folur dhe të shkruar. Aftësi të komunikimit efektiv me bashkëpunëtorët, aftësi të punojë me efikasitet në ekip dhe nën presion, jep zgjedhje kreative të problemeve si dhe aftësi organizative dhe përmbushje të afateve kohore. Duhet te tregoj fleksibilitet dhe gatishmëri të punojë jashtë orarit dhe në rastet emergjente. Njohuri të mira të punës me kompjuter si MS Office dhe Internet.
Njohuri të mira të gjuhës angleze.

2. Zyrtar për Burime Njerezore (BNj) (2- ekzekutues)

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:
